

№ 1001/353 prot.

Nr. ____ Prot. datë 18/06/2019

10464

Marrëveshje Bashkëpunimi

ndërmjet

Bashkisë Shkodër

dhe

Save the Children

Bashkia Shkodër, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr. 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**

dhe

Save the Children, me adresë: Rr. "Komuna e Parisit", Lagja 8, Pallatet "1 Maji", Vila "Lami", Tiranë; regjistruar si person juridik, Fondacion, me nr. Vendimi 3041, datë 05/11/1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; me nr. NIPT-i J92308003D, përfaqësuar nga **Znj. Anila Meço**, në cilësinë e Drejtores së Fondacionit "Save the Children në Shqipëri", këtej e tutje e cilësuar si "**Save the Children**"

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

NENI 1

Objekti

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i rroleve dhe përgjegjësiive të ndërsjellta në zbatimin e ndërhyrjeve që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, ofrimin e shërbimeve cilësore për grupet më të marginalizuara; promovimin e de-institucionalizimit të fëmijëve, me fokus të veçantë fuqizimin e familjeve në rrezik dhe fuqizimin e shërbimit të kujdestarisë familjare, duke respektuar realizimin e të drejtave të njohura nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Palët do të zbatojnë ndërhyrjet e përbashkëta në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe të udhëhequr nga parimi i "**interesit më të lartë të fëmijës**".



NENI II

Baza ligjore

Referuar Ligjit Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore, Ligji nr. 9062/2003 “Për Kodin e Familjes në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligji nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, Ligji nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat fitimprurëse, i ndryshuar, VKM nr. 148 datë 13.3.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërmjet mekanizmave këshëllimorë e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombetare e vendore si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”, VKM nr. 578 datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave mbrojtëse”, VKM nr. 149 datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestarie”

Konventa e OKB-se mbi t Konventa e OKB-së mbi të “Drejtat e Fëmijës” datë 20.11.1989; VKB nr. 84 date 20.12.2018 “Për miratimin e e Planit Social i Bashkisë Shkodër.

NENI III

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Save the Children në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim mbështetjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim; si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambjent familjar, qoftë ky familja biologjike apo familje alternative.

NENI IV

Rolet dhe përgjegjësitë e Save the Children

1. *Save the Children* garanton mbështetjen teknike dhe financiare në adresimin e këtyre çështjeve kryesore:
 - *Fuqizimi i sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve*
 - *Kujdesi alternativ*

Shenim: Save the Children zbaton komponentet e cituar me sipër në bashkëpunim me organizatat lokale: Shërbimet Sociale Bethani dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror -Arsis



2

2 *Save the Children merr përsipër këto angazhime:*

- 2.1 Të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër dhe insitucionet në varësi, në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në kuadrin e zbatimit të programit të mbrojtjes së fëmijëve objekt i kësaj marrëveshjeje;
- 2.2 Të mbështesë strukturat e shërbimit social në nivel Bashkie në ngritjen e kapaciteteve të tyre për vlerësimin e nevojave të grupeve vulnerabël dhe ndërtimin e planeve të ndërhyrjes;
- 2.3 Të mbështesë strukturat e Shërbimit Social në nivel Bashkie për ndërtimin e mekanizmave monitorues të cilësisë së shërbimeve dhe të ngrejë kapacitetet e tyre në matjen e indikatorëve të cilësisë;
- 2.4 Të mbështesë teknikiist specialistët e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Specialistin për De-institucionalizimin dhe Kujdesin Alternativ në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik institucionalizimi që janë identifikuar apo referuar tek kjo Njësi, rastet e fëmijëve në kujdes rezidencial në procesin e re-integrimit në familje biologjike dhe ndjekjen e planeve të ndërhyrjes për rastet;
- 2.5 Të mbështesë strukturat e shërbimeve sociale në nivel vendor në Shkodër në identifikimin dhe ngritjen e kapaciteteve të familjeve të mundshme kujdestare;
- 2.6 Të ndërtojë dhe zbatojë programe të ngritjes së kapaciteteve të prindërimit pozitiv si me prindër të familjeve në situatë krize ashtu dhe me prindër të mundshëm kujdestarë;
- 2.7 Të mbështesë nisma të përmirësimit të kuadrit ligjor, politikave dhe standardeve të shërbimit të kujdestarisë në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për kujdesin alternativ;
- 2.8 **Save the Children** do të rimbursojë shpenzimet për aktivitetet e listuara më sipër pas marrjes së raporteve të detajuar financiare dhe narrative për aktivitetet, evidenca nga përfituesit për marrjen e shërbimit dhe faturat financiare të shpenzimeve të kryera në përputhje me procedurat e Save the Children.
- 2.9 **Save the Children** angazhohet të paraqesë pranë Bashkisë Shkodër informacion të shkruar në mënyrë periodike, (çdo 3 muaj) mbi ecurinë e ndërhyrjeve të saj, objekt i kësaj marrëveshjeje, arritjet dhe problematikat e hasura.
- 2.10 **Save the Children** angazhohet të garantojë parimin e ruajtjes së konfidencialitetit për çdo informacion që lidhet me fëmijët në kujdes rezidencial apo me familjet e tyre si dhe çdo informacion tjetër sensitiv.

NENI V

Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër merr përsipër këto angazhime :

I. Në kuadër të fuqizimit të sistemit vendor të mbrojtjes së fëmijëve:

- 1.1 Të sigurojë angazhimin e vazhdueshëm dhe efikas të specialistëve të Drejtorisë së Shërbimit Social dhe strukturave në varësi, në identifikimin e fëmijëve në situatë rreziku, ngritjen dhe vënien në funksion të sistemit lokal të referimit për fëmijët në rrezik braktisjeje apo në shërbim rezidencial;



- 1.2 Të sigurojë shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me Save the Children në kuadër të hartimit të planeve për shërbimin e kujdestarisë për fëmijet rezidencialë dhe në rimëkëmbjen e marrëdhënieve me familjet biologjike;
 - 1.3 Të sigurojë bashkëpunimin e strukturave të tij të varësisë dhe stafeve të tyre me stafin e Save the Children për të promovuar te drejten e fëmijes për të jetuar në një familje qoftë kjo biologjike apo alternative nëpërmjet krijimit dhe koordinimit të rrjeteve të ofruesve të shërbimit në nivel lokal; koordinimit me struktura të tjera vendore;
 - 1.4 Të sigurojë bashkëpunimin e strukturave të tij të varësisë dhe stafeve të tyre me stafin e Save the Children (Bethani Shërbimet Sociale dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror – Arsis) për të promovuar te drejten e fëmijes për të jetuar në një familje qoftë kjo biologjike apo alternative nëpërmjet krijimit dhe koordinimit të rrjeteve të ofruesve të shërbimit në nivel lokal dhe koordinimit me struktura të tjera vendore;
 - 1.5 Të vërë në dispozicion një ambient fizik që të shërbejë si qendër informimi dhe shërbimesh mbështetëse dhe të trajnimit për familjet aplikante për kujdestari familjare;
 - 1.6 Të ushtrojë autoritetin e saj në shkëmbimin e informacionit në lidhje me situatën sociale dhe ekonomike të familjeve apo fëmijëve në kujdes rezidencial me shërbimet sociale të vendit të banimit të familjes së origjinës;
 - 1.7 Të koordinojë takimet e grupit teknik multidisiplinar për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik institucionalizimi, të mbikqyrë hartimin dhe plotësimin e dosjeve individuale të fëmijëve në menaxhim rasti si dhe të fëmijëve në rrezik institucionalizimi apo në proces de-institucionalizimi
2. **Bashkia Shkodër** do të lehtësojë procedurat dhe ndarjen e përgjegjësisë për mbështetjen siç parashikohet nga ligji në lidhje me shërbimet/përfitimet që vijnë nga Bashkia në përfitim të fëmijëve dhe familjeve të identifikuar apo të referuara tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Specialisti për De-institucionalizimin dhe Kujdesin Alternativ.
 3. **Bashkia Shkodër** do të garantojë pjesëmarrjen e stafeve të saj në të gjitha aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve të fushës së shërbimeve sociale sipas planeve të rëna dakord më parë me Save the Children.
 4. **Bashkia Shkodër** do të lehtësojë me mjete dhe burime që ka në dispozicion, të gjitha aktivitetet sensibilizuese si dhe fushatat ndërgjegjësuese me fokus ngjitjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, objekt i kësaj marrëveshje.
 5. **Bashkia Shkodër** krijon kushtet e nevojshme që Save the Children të përmbushë detyrimet siç përshkruhen në nenin IV të kësaj marrëveshjeje, përfshirë edhe caktimin e një personi kontakti.

NENI VI
Zbatimi i Marrëveshjes



Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e Programit dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.

Bashkia Shkodër dhe Save the Children caktojnë nga një person kontakti që do të jenë pjesë e komunikimit mes palëve, koordinimit të veprimeve dhe monitorimit hap pas hapi të zbatimit të programit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike informuese dhe vendim-marrëse. Në raste të caktuara, në marrëveshje mes tyre, Bashkia Shkodër dhe Save the Children, krijojnë grupe të përbashkëta teknike për hartimin e propozimeve konkrete për ofrim shërbimesh apo ndryshim politikash vendore, për tu paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak.

NENI VII **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri në 31 dhjetor të vitit 2021.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

NENI VIII **Përfundimi i marrëveshjes**

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
- b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- d. për forcë madhore

Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI IX **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.



5

NENI X
Dispozita të fundit

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

NENI XI
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në 2 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

Për Bashkinë Shkodër

Znj. Voltana Ademi
Kryetare



Për Save the Children

Znj. Anila Meco
Drejtoreshë

